

RIFINITURA



ULTRAFINISH

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	Thes, 15 Kg	1.2-1.5 (kg/m ²)/mm trashësi

PËRSHKRIM

Stuko patinimi me bazë çimento të bardhë, e përbërë nga gëlqere e hidratuar, rërë mermeri të cilësisë së lartë, rezina sintetike speciale dhe aditivë specifikë. I perforcuar me fibra Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, hapje shumë e mirë si në sipërfaqe horizontale ashtu dhe vertikale. Lejohet aplikimi deri në 3 mm trashësi. Pas fërkimit me letër smerile jep një rifiniture të lëmuar.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për stukimin e mureve dhe tavanëve në sipërfaqet e betonit, karton gips dhe në suva, për ambiente të jashtme dhe të brendshme. Stukoja e patinimit duhet të aplikohet në temperaturë nga +5°C deri në +35°C.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Nëse suporti ka disnivele të mëdha atëherë duhet të bëhet nivelimi i tij. Para aplikimit suporti laget me ujë.

APLIKIMI

Përzjeni 5.5-6 litra ujë me një thes 15 kg produkt me përzierës elektrik më numër të vogël rrotullimesh, derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni produktin në qetësi për 5 min dhe përzijeni përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me një mallë inoksi dhe bëni nivelimin e saj, në një trashësi prej 3 mm. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Trashësia: 1-2 mm/dorë
Paketimi: Thes letre 15 kg në paleta 1080 kg	Aplikimi i bojës: 2 ditë
Ngjyra: E bardhë	pH i përzierjes: 13
Konsumi: 1.2-1.5 kg/m ² (3mm trashësi)	Granulometria: 0.1 mm
Ruajtja: Ne paleta druri	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Mënyra e aplikimit: 2 duar	Forca në shtypje: 4.2 N/mm ²
Magazinimi: 12 muaj nga data e prodhimit	Thithja e ujit: WO
Masa Vëllimore: 1.15gr/cm ³	Konduktiviteti termik: 0.36 λ 10,dry
Sasia e ujit: 5.5-6 litra ujë per 25 kg produkt	Reaksioni ndaj zjarrit: A1 Class

